

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7185  
E enjte, 16 maj 2024  
Çmimi 0.50 €

Konjufca dhe Gjeloshaj  
diskutojnë për thellimin  
e bashkëpunimit  
Kosovë - Mali i Zi FAQE 7



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## SI DO TË VOTONIN PAKICAT PËR SHPËRNDARJEN E MUNDSHME TË KUVENDIT?

FAQE 4



Deputetët e pakicave në Kuvendin e Kosovës thonë se tash për tash nuk janë kontaktuar nga kryeministri Albin Kurti apo partia në pushtet - Lëvizja Vetëvendosje

për të diskutuar rreth datës së zgjedhjeve të reja, por shprehin mendime të ndryshme për mënyrën se si do të votonin nëse në rend dite do të dilte ndonjë mocion që do t'u hapte

rrugë atyre. Mandati i qeverisë aktuale përfundon në fillim të vitit 2025, por në diskutim është shpërndarja e Kuvendit si "opsion më real" për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme

## ISNI KILAJ LIROHET ME KUSHT NGA SPECIALJA F. 3



## RRIPI I SHPËTIMIT F. 3

Behxhet  
Sh. SHALA -  
BAJGORA



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## AKTUALE



PLAGOSËT KRYEMINISTRI  
I SLOVAKISË F. 2

ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË KIE NUK  
PËRFSHIHET NË AGJENDËN E  
KOMITIT TË MINISTRAVE F. 5

HAZIRI: NUK KENI PARË ASGJË  
AKOMA, DO TË SHOKOHEN  
BESIMTARËT POLITIKË TË KURTIT F. 7

## EKONOMI



LARGIMI I QYTETARËVE  
TË KUALIFIKUAR, SI PASOJË  
E PAGËS SË ULËT F. 8

DISKUTOHET PËR MUNDËSITË E  
BASHKËPUNIMIT EKONOMIK NË MES  
TË KOSOVËS DHE ARMENISË F. 8

## SPORT



MINISTRI ÇEKU REAGON  
ASHPËR NDAJ BASHKËPUNIMIT  
SHOIPËRI - SERBI: ISHIM GATI,  
POR S'NA PYETËN FARE F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelensky shtyn vizitat jashtë vendit për shkak të situatës së “vështirë” në front

Kiev, 15 maj - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka shtyrë të gjitha takimet e planifikuara jashtë vendit, një shenjë që tregon për vështirësitë me të cilat po përballen forcat ukrainase kundër avancimit të Rusisë në rajonin verilindor të Harkivit.

Zelensky kishte paraparë që në ditët në vijim t'i vizitonte Spanjën dhe Portugalinë dhe më 17 maj në Madrid ishte paraparë të nënshkruante një marrëveshje dypalëshe të sigurisë me kryeministrin spanjoll Pedro Sanchez. “Zelensky ka udhëzuar që të gjitha ngjarjet ndërkombëtare ku ishte paraparë të merrte pjesë në ditët në vijim, të shtyhen për data të tjera. Ne u jemi mirënjohës partnerëve tanë për mirëkuptimin”, tha zëdhënësi i tij, Serhiy Nykyforov.

Ukraina nuk ka dhënë asnjë arsye specifike për shtyrjen e takimeve, por Nykyforov shkroi në Facebook se Zelensky më 15 maj mbajti një takim me komandantët e tij, përfshirë edhe me komandantin e përgjithshëm, gjeneralin Oleksandr Syrskiy. Në takim është diskutuar situata në rajonin e Harkivit. “Forca shtesë rezervë po dislokohen në këtë zonë”, shkroi Nykyforov.

Rusia është duke kryer ofensivë në veri të rajonit të Harkivit dhe ushtria ukrainase tha më 15 maj se ka ndërmarrë hapa për t'i parandaluar forcat ruse të lëvizin në pjesën veriore të qytezës së Vovçanskut, që gjendet 5 kilometra larg kufirit me Rusinë.

Vovçansku është bërë epiqendër e ofensivës së fundit ruse, përdorur forcat e Kremlinit po



tentojnë të marrin nën kontroll vendbanime në lindje të Harkivit - qytetit të dytë më të madh të Ukrainës, që para luftës

kishte 1.4 milion banorë. Trupat e Moskës hynë në rajonin e Harkivit më 10 maj duke hapur një front të ri në

verilindje të Ukrainës. Avancimi rus mund të bëjë që disa forca të Kievit të tërhiqen nga lindja, ku Rusia po bën përpunim të ngadalshëm.

Analistët thanë se Rusia po tenton të bëjë përpunime në fushëbetë, para se vala e ndihmës së re ushtarake për Kievin të shkojnë nga Shtetet e Bashkuara dhe shtetet evropiane. Paketat e reja të ndihmës pritet të shkojnë në Kiev në javët në vijim.

Një ditë më herët Rusia pretendoi se ka marrë kontrollin e fshatit kufitar, Buruvatka, por ky pretendim nuk ka mundur të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Kryetari i Harkivit, Ihor Terekhov, deklaroi të mërkurën se, pavarësisht prej sulmeve të vazhdueshme ruse, nuk ka plane për evakuimin e qytetit.

## Më 23 maj OKB-ja voton për rezolutën për Srebrenicën

Nju-Jork, 15 maj - Draft-rezoluta e propozuar për gjenocidin në Srebrenicë do të jetë në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 23 maj, u tha në uebfaqen e këtij institucioni.

Rezoluta e propozuar mëton ta shpallë 11 korrikun “Ditë Ndërkombëtare të Kujtimit dhe Shënimit të Gjenocidit të vitit 1995 në Srebrenicë”.

Rezoluta u referohet fakteve të përcaktuara nga aktgjykimet e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ashtu si edhe të gjykatave vendase.

OKB-ja, siç thuhet në tekstin e rezolutës, “dënon pa rezervë çdo mohim të gjenocidit në Srebrenicë si fakt historik dhe u bënë thirrje shteteve anëtare t'i ruajnë faktet, përfshirë përmes sistemeve arsimore, duke zhvilluar programe të përshtatshme, po ashtu si shenjë të kujtesës, në mënyrë që të parandalohet mohimi dhe shtrembërimi i fakteve dhe kryerja e gjenocidit në të



ardhmen”.

Sipas rezolutës së propozuar, OKB-ja “dënon pa rezerva veprimet që madhërojnë ata që janë dënuar nga gjykatat ndërkombëtare për krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid, përfshirë edhe përgjegjësit për gjenocidin në Srebrenicë”.

Në tekst, po ashtu, theksohet rëndësia e përfundimit të procesit të gjetjes dhe

identifikimit të mbetjeve mortore të viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, në mënyrë që ata të varrosen në mënyrë të dinjitetshme, dhe bëhen thirrje për vazhdimin e ndjekjes penale për kryesit e gjenocidit në Srebrenicë, të cilët ende nuk janë përballur me drejtësinë.

Rezoluta u bënë thirrje “të gjitha shteteve që t'i respektojnë obligimet e tyre sipas Konventës

për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe të drejtën ndërkombëtare zakonore për parandalimin dhe ndëshkimin e gjenocidit, duke respektuar vendimet përkatëse të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë [GJND]”.

Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së i kërkohet “të themelojë një program informues të titulluar ‘Gjenocidi në Srebrenicë dhe OKB-ja’”, që do të niste me aktivitete dhe përgatitje për 30-vjetorin e gjenocidit më 2025, duke i kërkuar sekretarit që t'ua tërheqë vëmendjen të gjitha shteteve anëtare të kësaj rezolute, organizatave të OKB-së dhe atyre të shoqërisë civile që ta tregojnë respektin e duhur”.

Po ashtu, rezoluta e OKB-së “u bënë thirrje të gjitha shteteve anëtare, organizatave të sistemit të OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare e rajonale dhe shoqërisë civile, përfshirë organizatave joqeveritare, institucioneve akademike dhe pjesëmarrësve të tjerë të rëndësishëm, që ta shënojnë Ditën Ndërkombëtare, përfshirë

edhe shënime të veçanta dhe aktivitete për të përkujtuar dhe nderuar viktimat e gjenocidit në Srebrenicë më 1995, si dhe edukimin e aktivitetet e duhura për ta rritur ndërgjegjësimin publik”.

Gjermania dhe Ruanda janë “sponsorizueset” e rezolutës për gjenocidin në Srebrenicë, pasi këto dy shtete bashkërisht e iniciuan dhe hartuan tekstin e rezolutës për Srebrenicën.

Më pas, 32 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara u bënë “bashkësponsorizuese”, si vende që morën përsipër detyrën e prezantimit të draftit para 193 shteteve anëtare të OKB-së.

Për gjenocidin në Srebrenicë, ku u vranë të paktën 8 372 boshnjakë, dhe për krimet e tjera të kryera në këtë rajon, më shumë se 50 persona janë dënuar me rreth 700 vjet burgim. Në mesin e të dënuarve janë edhe presidenti i Republikës Serpska në kohën e luftës, Radovan Karaxhiq, dhe komandanti i përgjithshëm i ushtrisë së atëherëshme serbe, Ratko Mlladiq.

## Plagoset kryeministri i Sllovakisë

HANDLOVA, 15 MAJ - Kryeministri i Sllovakisë, Robert Fico, është plagosur të mërkurën në një incident me të shtëna pas një takimi të qeverisë në afërsi të Bratislavës, raporton televizioni sllovak TA3.

Incidenti ndodhi në qytetin Handlova, rreth 150 kilometra në verilindje të kryeqytetit. I dyshuari është arrestuar,


sipas TA3.

Nënkryetari i Parlamentit të Sllovakisë, Lubos Blaha, konfirmoi incidentin gjatë një seance parlamentare, të cilën e shtyu për datë të papërcaktuar, njoftoi agjencia sllovaqe e lajmeve, TASR.

Nuk dihet sa rëndë mund të jetë plagosur Fico. Ai u dërgua menjëherë në spital, raporto TASR, duke e cituar Blahan.

Gazetarët, të cilët ishin në vendin e ngjarjes, thanë se u dëgjuan disa të shtëna me armë. Ata shtuan se zyrtarët e sigurisë e futën një person në një veturë dhe u larguan me shpejtësi.

I arrestuari besohet se është i dyshuari që shtiu mbi kryeministrin, megjithëse kjo nuk është konfirmuar nga policia lokale.



# Isni Kilaj lirohet me kusht nga Specialja

PRISHTINË, 15 MAJ - Dhomat e Specializuara në Hagë kanë njoftuar të mërkurën se është liruar "me kushte të rrepta", ish-kryetari i komunës së Malishevës, Isni Kilaj. Lirimi i tij me kusht është mundësuar pas dhënies së dorëzimit prej 30 000 eurosh. Në nëntor të vitit 2023 Kilaj u arrestua nga Dhomat e Specializuara në Hagë, në dyshimet për veprat penale që kanë të bëjnë me pengimin e drejtësisë. Pavarësisht se ai është liruar me kusht, Dhomat e Specializuara thanë se në vendimin për rishikimin e paraburgimit ndaj Kilajt, gjykata ka konstatuar se "ende ekziston dyshimi i bazuar që Kilaj ka kryer vetë ose së bashku me të tjerë, vepra penale kundër administrimit të drejtësisë". Gjykata tha se, pavarësisht prej vendimit për lirim, ka ende rrezik "të moderuar" që Kilaj të arratiset dhe ta pengojë ecurinë e procedurave penale si dhe "të kryejë vepra të tjera penale". Megjithatë, gjykatësi arriti në përfundim se zgjatja e paraburgimit të zotit Kilaj, në rrethanat aktuale do të ishte e paarsyeshme, duke marrë në konsideratë prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën e tij për liri në rrethanat e zhvillimeve të reja", u tha në njoftim. Po ashtu, ndër arsyet e vendimit për lirin e Kilajt u përmend edhe vendimi i Prokurorisë së

Specializuar që synon të paraqesë një aktakuzë të ndryshuar ndaj tij dhe kjo mund të marrë kohë. Në njoftimin e Dhomave të Specializuara, që ndryshe njihen edhe si Gjykata Speciale, u theksua se Kilaj mund të dënohet deri me pesë vjet burgim për veprat për të cilat dyshohet. Kilaj ka qëndruar për pothuajse gjashtë muaj në qendrën e paraburgimit në Hagë. Kur u arrestua, Prokuroria e Specializuar tha se ai dyshohet për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkeljen e sekretit të procedurave. Kilaj kishte drejtuar komunën e Malishevës në dy mandate, nga 2007 deri më 2009 dhe nga 2009 deri më 2013. Më 2015 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Gjykatën Speciale, e cila funksionon me ligje të Kosovës, por në territorin e Holandës. Në këtë institucion punojnë prokurorë dhe gjykatës të huaj. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Deri më tani Specialja ka



shqiptuar dënim për pengim të drejtësisë ndaj ish-kryerëve të Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, të cilët vitin e kaluar u

liruan me kusht. Aktualisht në Dhomat e Specializuara janë duke u zhvilluar dy raste gjyqësore: ai ndaj ish-kryerëve të UÇK-së Hashim Thaçi, Kadri Veseli,

Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Rasti i dytë ka të bëjë me akuzat për krime lufte ndaj Pjetër Shalës.

## Doktori i shkencave juridike, Murtez Zekolli, i bashkohet Nismës Socialdemokrate



PRISHTINË, 15 MAJ - Nismës Socialdemokrate i është bashkuar të mërkurën Murtez Zekolli, i cili mban titullin doktor i shkencave juridike. Kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, ka thënë se Zekolli gjatë luftës ishte një bashkëluftëtar i dalluar, derisa pas lufte nuk rreshti aktivitetin në të mirë të shtetit dhe shoqërisë. Limaj ka thënë se dr. Zekolli do të jetë vlerë e shtuar për subjektin e tyre politik. "Kemi nderin dhe kënaqësinë t'i urojmë mirëseardhje dr. Murtez Zekollit. Z. Zekolli, një personalitet i nderuar i bashkohet subjektit tonë politik me një bagazh kombëtar dhe intelektual, që

rrjedh nga një familje patriotike e lirisdashëse. Si profesionist i dëshmuar, z. Zekolli mban titullin doktor i shkencave juridike, gjatë luftës ishte një bashkëluftëtar i dalluar, derisa pas lufte nuk rreshti aktivitetin në të mirë të shtetit dhe shoqërisë. Si ish-kandidat për kryetar të komunës së Suharekës, ai nje mirë problemet dhe hallet e qytetit të tij por, natyrisht, edhe temat kombëtare e profesionale. Dr. Zekolli është vlerë e shtuar për subjektin tonë politik. Urime dhe suksese të përbashkëta në objektivat tona, duke respektuar të kaluarën tonë historike dhe duke punuar për të ardhmen euroatlantike", ka thënë Limaj.

## Osmani bisedon me presidentin gjerman për rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në KiE

Prishtinë, 15 maj - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, të martën ka zhvilluar një bisedë telefonike me homologun gjerman Frank-Walter Steinmeier. Osmani dhe Steinmeier kanë diskutuar rreth anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e

Evropës. Ajo theksoi rëndësinë kritike për përfundimin me sukses të këtij procesi. "Për të siguruar që të gjithë qytetarët tanë të përfitojnë sa më shpejt nga instrumentet e Këshillit", tha Osmani përmes një postimi në "X". "Anëtarësimi ynë nuk do të ishte vetëm një

fitore për të drejtat e njeriut në Kosovë, por edhe një fitore për kontinentin tonë dhe vlerat mbi të cilat ai qëndron fuqishëm", shtoi e para e shtetit të Kosovës. Deri më tani Kosova nuk është futur në agjendën e mbledhjes së Këshillit Ministror të KiE-së.





# Si do të votonin pakicat për shpërndarjen e mundshme të Kuvendit?

Deputetët e pakicave në Kuvendin e Kosovës thonë se tash për tash nuk janë kontaktuar nga kryeministri Albin Kurti apo partia në pushtet - Lëvizja Vetëvendosje për të diskutuar rreth datës së zgjedhjeve të reja, por shprehin mendime të ndryshme për mënyrën se si do të votonin nëse në rend dite do të dilte ndonjë mocion që do t'u hapte rrugë atyre. Mandati i qeverisë aktuale përfundon në fillim të vitit 2025, por në diskutim është shpërndarja e Kuvendit si "opcion më real" për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme

Prishtinë, 15 maj - Deputetët e pakicave në Kuvendin e Kosovës thonë se tash për tash nuk janë kontaktuar nga kryeministri Albin Kurti apo partia në pushtet - Lëvizja Vetëvendosje - për të diskutuar rreth datës së zgjedhjeve të reja, por ndajnë mendime të ndryshme për mënyrën se si do të votonin nëse në rend dite do të dilte ndonjë mocion që do t'u hapte rrugë atyre.

Mundësia për zgjedhje të parakohshme u aktualizua më 13 maj kur vetë Kurti tha se është i gatshëm të diskutojë me partitë opozitare për një datë të mundshme.

Me kritika për keqqeverisje, partitë opozitare ka kohë që kërkojnë mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

Mandati i qeverisë aktuale përfundon në fillim të vitit 2025, por në diskutim është shpërndarja e Kuvendit si "opcion më real" për mbajtjen e

zgjedhjeve të parakohshme.

Në Kuvendin me 120 ulëse të Kosovës, nëntë ulëse i ka Lista Serbe; tetë grupi multietnik; pesë deputetë - në mesin e tyre një serb - janë pa grup parlamentar, ndërsa pjesa tjetër u takon katër partive më të mëdha shqiptare: 56 Lëvizjes Vetëvendosje, 18 Partisë Demokratike të Kosovës, 16 Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe tetë Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

I pyetur nga Radio Evropa e Lirë se si do të votonte në rast se do të iniciohej procedura për shpërndarjen e Kuvendit, kryetari i Listës Serbe, Zllatan Ellek, thotë se kjo parti nuk ka ende ndonjë qëndrim. "Vetë nuk mund t'i përgjigjem kësaj. Për vendime të tilla qëndrimin duhet ta marrë Kryesia e Listës Serbe", thotë ai.

Enis Kervan, shef i grupit parlamentar Multietnik, thotë se vota e tij do të jetë për shpërndarje të Kuvendit. Por,

deputetë të tjerë nga ky grup, përveç deputetes Duda Bale, thonë se ende nuk kanë vendosur se si të veprojnë nëse kërkohet vota e tyre. "Nëse është marrëveshje dhe nëse shumica voton për, edhe unë do të votoj për", thotë Bale për REL-in, duke shtuar se Grupi Multietnik do të mbajë një takim të enjten, kur edhe do të vendoset "për hapat tutje".

Erxhan Galushi, nga po ky grup, thotë se mundësia për zgjedhje të parakohshme është bërë "si zhvillim shumë i shpejtë". "Shpresoj dhe besoj se edhe kryeministri ndoshta do të na thërrasë edhe neve dhe, pas asaj, do të mund të dalim me një qëndrim konkret", thotë ai. "Duhet të konsiderohen disa faktorë. Nesër e kemi seancën [e Kuvendit] ku janë edhe marrëveshjet ndërkombëtare, për momentin nuk kam ndonjë vendim", thotë deputeti Fridon Lala nga Grupi Multietnik.

Zgjedhjeve të reja mund t'u hapet rrugë me mocion të shpërndarjes së Kuvendit me dy të tretat e votave, me mocion për shkarkimin e kryeministrit, ose me mocion të votëbesimit ndaj qeverisë që do ta kërkonte kryeministri.

Eugen Cakolli, nga Instituti Demokratik i Kosovës, i tha më herët REL-it se shkarkimi i kryeministrit është më pak i mundshëm. "Opsioni më real në këtë situatë mbetet shpërndarja

e Kuvendit", tha ai.

Deputeti pa grup parlamentar, Haki Abazi, thotë për REL-in se nuk do të votojë për shkarkimin e Kurtit apo shpërndarjen e Kuvendit. "Nuk ka asnjë arsye që Parlamenti ta marrë përgjegjësinë për dështimin e qeverisë dhe dështimet në anëtarësimin në Këshill të Evropës", thotë ai.

Abazi, i cili ishte pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje, thotë se do të votojë kundër ose do të abstenojë, në rast se do të ketë mocion për shpërndarjen e Kuvendit apo shkarkimin e Kurtit. "Çfarëdolloj shkurtimi i mandatit do të krijonte justifikim dhe viktimizim për Kurtin, dhe do ta defokusonte debatin prej asaj që do të duhej të ishte - llogaridhënie dhe matje e rezultateve", thotë Abazi.

Deputeti tjetër pa grup parlamentar, Fatmir Humolli, thotë se vota e tij do të ishte për nëse mocioni bëhet "për shkak të mosrealizimit të programit të fushatës elektorale [të kësaj qeverie].

"Sigurisht do të votoj. Kësaj qeverie i ka kaluar mandati prej popullit që vitin e dytë të qeverisjes", thotë Humolli - dikur pjesë e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje - për Radion Evropa e Lirë.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës në opozitë, Memli Krasniqi, tha më 13 maj, pas një takimi me Kurtin, se zgjedhjet e

reja janë të domosdoshme. Ai tha se PDK-ja është e gatshme të gjejë një pajtim me të gjitha partitë parlamentare "për një datë të re të zgjedhjeve, për ta shpërndarë Kuvendin përmes një mocioni të përbashkët".

Por, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dy parti po ashtu në opozitë, kërkojnë që shpërndarjen e Kuvendit t'i paraprijë shkarkimi apo dorëheqja e kryeministrit Kurti. Këtë opsion e hodhi poshtë Lëvizja Vetëvendosje.

Për zgjedhjet, Kurti bisedoi të martën edhe me udhëheqësit e partive Guxo dhe Alternativa.

Për iniciimin e procedurës së shpërndarjes së Kuvendit, sipas Cakollit, kërkohet thirrja e një seance të jashtëzakonshme nga së paku 40 deputetë. Sipas tij, arritja e së paku 80 votave të nevojshme për këtë mocion "nuk do të ishte e vështirë" nëse merren parasysh numrat që i kanë Vetëvendosja, PDK-ja dhe komunitetet pakicë joserbe.

Data për mbajtjen e zgjedhjeve caktohet nga presidentja e vendit pas konsultimeve me partitë politike. Kjo ndodh pasi të shpërndahet Kuvendi.

Zgjedhjet duhet të mbahen më së largu deri në 45 ditë nga data e shpalljes së tyre, por Cakolli nuk e përjashton mundësinë që ato të thirren edhe brenda afatit të shkurtër që është 30 ditë.

# Anëtarësimi i Kosovës në KiE nuk përfshihet në agjendën e Komitetit të Ministrave

PRISHTINË, 15 MAJ - Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës nuk është përfshirë në agjendën e Komitetit të Ministrave të kësaj organizate që do të mbledhet këtë javë. Kështu ka njoftuar zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës i Kosovës, Kreshnik Ahmeti, në "Facebook". Ahmeti ka thënë se, pavarësisht prej mbështetjes që gëzon Kosova për anëtarësim në Këshillin e Evropës - organizatën lidere në fushën e të drejtave të njeriut - janë disa vende që kërkojnë prej Kosovës ta pranojë "draft-statutin e [të dërguarit të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi] Miroslav Lajçakut për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe ta dërgojë atë në Gjykatë Kushtetuese, në një mënyrë që është e pranueshme për Gjykatën". "Ka gjasë që ky votim të shtyhet. Shtyrja eventuale vjen si rezultat i ngatërimit të dy proceseve të pavarura, me ç'rast



Këshilli i Evropës po shfrytëzohet si levë presioni mbi Kosovën për ta pranuar draft statutin e Lajçakut dhe për ta dërguar atë në Kushtetuese, në shpërputhje edhe me procesin e dialogut në Bruksel", ka thënë mes tjerash

Ahmeti. Sipas tij, kërkesa për Asociacionin nuk ka të bëjë aspak me vlerat dhe parimet e Këshillit të Evropës dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. "Shtyrja eventuale do t'i kufizojë

mundësitë e qytetarëve, përfshirë minoritetin serb, t'i përdorë mekanizmat e Këshillit të Evropës, përfshirë Gjykatën e Strasburgut për t'i adresuar të drejtat e tyre. Për më tepër, shtyrja do ta dërgojë një sinjal shumë shqetësues për

vendet e rajonit", ka vlerësuar Ahmeti.

Më 16 prill Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e ka mbështetur raportin që rekomandon anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë me seli në Strasburg.

Autorja e raportit, Dora Bakoyannis, ka thënë se Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet për anëtarësim dhe çështjen e formimit të Asociacionit e ka konsideruar si temë të brendshme të Kosovës. Megjithatë, ka ditë që qarkullojnë informacione se disa vende të Perëndimit janë duke kërkuar që Kosova të shënojë përparim drejt formimit të Asociacionit, në mënyrë që të pranohet në këtë organizatë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë ditë më parë se qeveria e tij nuk do ta pranojë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe si kusht për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.

## Osmani u prit në takim nga kryeministrja e Danimarkës: Mbështetja e Danimarkës për Kosovën ka qenë e palëkundur



Prishtinë, 15 maj - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, është pritur në mërkurën në takim në Pallatin Christiansborg nga kryeministrja e Mbretërisë së Danimarkës, Mette Frederiksen. Në takim është diskutuar për marrëdhëniet bilaterale midis dy shteteve dhe është rikonfirmuar përkushtimi i ndërsjellë për rritjen e bashkëpunimit ndërshtetëror në të mirën e qytetarëve të të dyja vendeve.

Në takim me kryeministren Frederiksen, presidentja Osmani ka falënderuar Mbretërinë e Danimarkës për mbështetjen ndaj Kosovës përgjatë viteve, ndërsa ka diskutuar edhe për rëndësinë që kjo mbështetje të vazhdojë edhe më tej për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, anëtarësimin në NATO, si dhe organizata ndërkombëtare. Në këtë drejtim Osmani ka

shprehur mirënjohjen për mbështetjen unanime të deputetëve danez në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës si dhe për gatishmërinë e qeverisë së Danimarkës që ta mbështesë vazhdimisht Kosovën deri në anëtarësim.

Presidentja Osmani dhe kryeministrja Frederiksen diskutuan edhe për presidencën daneze të Bashkimit Evropian vitin e ardhshëm, ku presidentja shtroi nevojën që të ndërmerren hapa konkretë sa i përket integritit të Kosovës në BE, duke u bazuar në performancën dhe reformat e realizuara në vendin tonë.

Osmani, po ashtu, shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e mbi 13 mijë ushtarëve danezë për paqen dhe sigurinë në Kosovë që nga viti 1999, ndaj bëri nderime te Monumenti Kombëtar i Kujtesës së Danimarkës, ku presidentja u prit me nderime ushtarake.

## Kurti bashkëbisedoi me studentët e Akademisë Diplomatike të Vjenës

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar të mërkurën një bashkëbisedim me studentët e Akademisë Diplomatike të Vjenës, të cilët po qëndrojnë për një vizitë studimore në Kosovë.

Teksa iu uroi mirëseardhje në shtetin tonë, kryeministri Kurti tha se edukimi është një mjet i fuqishëm që ndërton baza për bashkëpunim të mirë, siç është rasti me marrëdhëniet e veçanta

në mes të Kosovës dhe Austrisë. Në kuadër të këtij bashkëbisedimi ai trajtoi elementet që dëshmojnë potencialin e Kosovës për zhvillim, teksa më pas përmendi dhe lansimin e djeshëm të platformës "Made in Kosova".

Kryeministri Kurti shprehur se qeveria është e përkushtuar në ndërmarrjen e reformave politike e ekonomike me synim rritjen e transparencës dhe krijimit të

kushteve të favorshme për investitorë lokalë dhe ndërkombëtarë.

Ai theksoi disa prej politikave të ndërmarra të cilat kanë pasur synim ndikimin në përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve pa dallim, si dhe evidentoi disa prej të arriturave në indikatorët makroekonomikë, si dyfishimi i eksporteve apo edhe ai i investimeve të huaja direkte në tri vitet e fundit.



# RRIPI I SHPËTIMIT



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Pas darkës, kush do të ketë barkdhimbje: Albin Kurti dhe Memli Krasniqi e hëngrën Darkën e Fundit në "Garden". Para se të takohen në restorantin Garden - Park kaluan një rrugë përplot me thera duke u ballafaquar në jo pak raste me një gjuhë kaktusi që thumboheshin, nga pozita sulmuese dhe mbrojtëse.

Albin Kurti kishte qëndrim shpërfillës, nënçmues, fyes, të pandershëm dhe brutal ndaj opozitës, specifikisht kundër PDK-së ndërkaq që LDK-në e mbante nën kontroll përmes cowgirl - lopares që po bënë sfilata nëpër rançet e Amerikës e që për fatin tonë të shëmtuar është presidente e Kosovës. LV-ja gjithmonë e ka trajtuar LDK-në si patericë rezervë nëse i thyhen këmbët qeverisë. E takova një mik para dy jave dhe, në bisedë e sipër folëm për koalicionet e mundshme. Unë mbroja qëndrimin se koalicioni do të jetë midis LV-së dhe LDK-së sepse kanë shumë pika afruese dhe fare pak dalluese përkatësisht ishte një bashkëdyzim midis Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit, si urryes patologjik të UÇK-së ndonëse nuk lënë masakër a ngjarje nga lufta pa përkujtuar. Ndershmërisht e pandershme, moralisht e pamoralshme! Nuk ka urrejtës më të mëdhenj të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit se Albin Kurti dhe Vjosa Osmani edhe pasi i dërguan në Burgun në Hagës. Edhe tash i urrejnë, fort dhe ulët ani pse falë tyre sot i kanë këto piste që i kanë.

Opozita në Kosovë ka qenë e mjerë, tani është edhe më e mjerë. Pozita me arrogancën e mbi 50 për qind të votave, gjatë këtij mandati nuk e ka bërë asnjë punë të hajrit në planin e mirëqenies sociale, politik, ekonomik, investimeve kapitale ndërkaq që në arenën diplomatike ndërkombëtare, pa asnjë njohje dhe pa asnjë anëtarësim në ndonjë institucion ndërkombëtar e ka promovuar

prostitucionin diplomatik përmes një injoranteje, ndryshe urrejtëse patologjike e UÇK-së, të burgosurve politikë dhe Bacë Adem Demaçit. Tash, po kjo analfabete diplomatike deklaroi se mund të bëjnë koalicion me PDK-në vetëm pasi kjo parti të lirohet nga kriminelët kurse Thaçin, Veselin, Krasniqin, Selimin dhe të tjerët i konsideron super kriminelë prandaj, me të gjitha forcat është angazhuar që ata të dërgohen në Hagë me dëshirë që mos të kthehen kurrë. Realisht, kjo farë fatkeqësie diplomatike në rrethanat si janë duke u zhvilluar pozitën më të lartë që mund të ketë është si ndihmëse e Xhevahire Izmakut apo përkthyes e Artan Nimanit, ndryshe përforcime me forcë nukleare politike të Nismës dhe AAK-së. Ai miku që e përmenda më lartë më tha se qenkam totalisht i painformuar shkaku se po punohet për koalicionin ZDRAVO dhe PRONTO. Mbeta i pajalë.

Çka i parapriu Darkës së Judes: KM Albin Kurti që nuk lë konferencë a kanaxheq që e bëjnë partitë e majta në Evropë pa marrë pjesë ndonëse e bënë jetën e superaristokratit, nga Gjermania lëshoi kushtrimin se personalisht do të angazhohet që ta bëjë shumicën parlamentare për kalimin e Marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe të Kodit Civil. Kjo siguri në deklaram u bë vetë pasi, si po duket mori premtimin e një partie, duket të jetë kjo PDK se do ta votojë kalimin e këtyre marrëveshjeve. Prandaj Kurti, me dinakërinë, inteligjencën dhe bizantinizmin e papërsëritshëm e hodhi karremin e një takimi për dinamizim të të legjislacionit ani pse Kosova ka shumë probleme më të mëdha dhe më akute për t'i zgjedhur. Nuk është aspak e rastit që këtë karrem e hodhi para mbajtjes së mbledhjes vjetore të ministrave në Këshill të Evropës ku më parë

nga institucionet kosovare morëm garanci se Kosova do të bëhet anëtare e këtij Institucioni numër 1 botëror për mbrojtje të drejtave të njeriut. Tash po del të mos jetë e përfshirë as në rend ditë çështja e anëtarësimit. I gjetur lakuriq si mbreti në përrallat e Andersonit, Albin Kurtit i është dashur një gjethë fiku për ta mbuluar lakuriqësinë, dështimin në Këshill të Evropës dhe këtë e siguroi përmes takimit me PDK-në, në Darkën e Fundit që mençurisht e refuzuan LDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte politike shumë drejt treguan adresën ku duhet të diskutohet tema e propozuar nga KM Kurti, Kuvendi i Kosovës dhe grupet parlamentare janë adresat për këtë temë. Lehtësia me të cilën PDK-ja e pranoi ftesën për darkë nxit dyshime përtej të bazuara për ndonjë allishverish pas zgjedhor apo qeveritar midis LV-së dhe PDK-së ndonëse ende në fazë të spekulimeve. Memli Krasniqi, kryetar i PDK-së më herët pati refuzuar takimet me Kurtin, kishte qëndrim shumë të drejtë për Marrëveshjen shkatërruese të Brukselit me aneks të Ohrit, që, nëse zbatohet siç ishte zotuar parqet fundin e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran dhe hyrje në një marrëdhënie kushtëzuese federative apo konfederative me Serbinë. Në këtë darkë të fundit pak ka rëndësi a është biseduar apo jo për caktim të datës zgjedhjeve të parakohshme sa kë rëndësi se Albin Kurtit dhe LV-ja, nga një përrua i ngushtë me llum ku ka hyrë me fajin e tyre iu krijua mundësia të dalin në një autostradë, sikur t'i kishin bërë punët më së miri në botë. Albin Kurti këtë e kërkoi dhe, me naivitetin foshnjor ia dhanë. Opozita aktuale, e përçarë dhe pa asnjë ndikim në asnjë rrethanë nuk duhet të pranojnë zgjedhjet e parakohshme pavarësisht nëse këtë e kërkon Kurti apo Murti. Opozita duhet fuqishëm të këmbëngulë që qeveria ta

përfundojë mandatin e rregullt sepse pikërisht me këtë i rriten gjasat të ndahet më mirë. Albin Kurtit dhe LV-ja i duhen zgjedhjet e parakohshme sikur që peshkut i duhet uji. Me zgjedhje të parakohshme LV-ja fiton por Kurti nuk bëhet kryeministër. Me zgjedhje të parakohshme hipotetishtë mund të bëhet një koalicion midis LV-së dhe PDK-së dhe, nëse ndodhë kjo shëmti, në fakt do të certifikohet fillim i fundit të PDK-së, si forcë politike. A ishte ky vendim personal i Memli Krasniqit e unë mendoj se nuk ishte, nuk ka fare rëndësi për faktin se përligji barbarizmin e Kurtit dhe LV-së kundër Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe pengjeve tjera të Hagës dhe Prishtinës përmes videove akuzuese dhe qëndrimeve publike, asnjëherë pozitive. Albin Kurti ishte në probleme të mëdha, thuaja të pazgjidhshme prandaj kërkonte shpëtim nga opozita kosovare të cilën pa asnjë konsideratë brutalisht e ka dhunuar që nga fillimi i mandatit qeverisës. Albin Kurti nuk e meriton përkrahjen e opozitës për zgjedhje të parakohshme por e meriton përkrahjen e opozitës për ta përfunduar mandatin e rregullt qeverisës.

E ka kërkuar këtë mandat, ndihmoni ta përfundojë, pa u ngatërruar në asnjë përgjegjësi që nuk iu takon fare si opozitë. Kosova me asgjë nuk mund të dëmtohet me shumë se që është dëmtuar me Marrëveshjen e Brukselit dhe bishitin e Ohrit. Deri dje Memlin këta cyberzagarët e LV-së dhe vet Albinin e bënë për pesë pare, sot, pas darkës po e quajnë konstruktiv, e pabesueshme edhe për personat me inteligjencë të Dilmalit dhe Hallilit. Për veten time e kam të qartë pse ndodhi ky takim por ua rikujtoj arkitektëve se nuk do iu dalin llogaritë ashtu si i kanë bërë projektet, Albinin do i lë në baltë të gjallë që të mbyten me shumë vuajtje dhe mundime. Nëse

projektuesit dhe zbatuesit e këtij allishverishi nuk mbledhin mend, jo që nuk do ta mundin Albinin dhe LV-ja por vetëm do ta rrisin LDK-në dhe AAK-në që do ta fitojnë luftën, pa shkrepur asnjë plumb. Albinin e pati rastin që me një përqindje mbi 50 për qind të votave, pa u penguar fare nga opozita dhe me një presidente që kashagitë kuaj dhe pela në Amerikë, të bëjë punë të mëdha për Kosovën, Shqipërinë, trojet shqiptare dhe Kombin. Nuk e bëri sepse nuk desh të jetë shërbyes i këtij misioni por sundues fuqiplotë. Këtu vdesë premtimi i tij dhe mundësia të bëhet si Hasan Prishtina. Ndjenja e madhështisë dhe egoja e personalitetit kanë rrënuar personalitete të fuqishme botërore për ta kursyer një të pafuqishëm jashtë zyrës së Kryeministrit dhe të LV-së siç është Albin Kurti.

Me Çetën e Profetëve Rrogëtarë në Luginë që udhëhiqen nga rreshterët politikë si Shaip Kamberi dhe Arben Travari vdes edhe angazhimi i sinqertë për çështje kombëtare.

Për fund: japonezët e respektojnë deri në fanatizëm Kultin e Paraardhësve duke u lutur për ta në shenjë falënderimi çdo mëngjes ndërkaq ne e bëjmë të kundërtën, i shkelim dhe harrojmë vlerat njerëzore dhe kombëtare për ndryshkun moral me prejardhje dhe bindje jugosllave dhe serbe që nuk kanë dhënë asnjë kontribut për luftën për liri por me të gjitha mjetet luftojnë sot kundër vlerave njerëzore dhe kombëtare. Të tillë sot më së shumti ka në LV-ja, pa asnjë dyshim. Opozita duhet të shkojë e bashkuar në takim me Kurtin jo për të përkrahur zgjedhjet e parakohshme por për t'i refuzuar ato. Zgjedhjet e parakohshme nuk janë zgjidhje për opozitën por janë zgjidhje për Albin Kurtin dhe LV-ja prandaj po e bëjnë këtë zgjedhje.

## Molliqaj: E vërteta është paksa e hidhur për Memlin dhe PDK-në

Prishtinë, 15 maj - Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka reaguar rreth zhvillimeve të fundit në vend. Ai ka thënë se opozita nuk është duke e kuptuar që të gjithë ekzistencën e saj është duke e zhvilluar në narracionin e Kurtit. Molliqaj ka thënë se është për keqardhje kur e

sheh opozitën në takime me Kurtin. "Të tillë, çdo arritje në sytë e tyre është jo pse ata vepruan apo punuan, por se Kurti po ua dhuron, sepse i përshtatet atij. PDK-ja e kapi bajrakun dhe Memli po përpiket të tregohet modest, se nuk e ka për protagonizëm. Memli me të vërtetë e

konsideron fitore të tij marrëveshjen me Kurtin për zgjedhje dhe veten protagonist në këtë skenë. E vërteta është paksa e hidhur për Memlin dhe PDK-në, për keqardhje kur e sheh opozitën dhe e rrezikshme për Kosovën. Protagonist përbrenda opozitës ndoshta edhe mund

të bëhesh Memli, ti dhe PDK-ja, por vetëm përbrenda skenarit të cilin Kurti e ka shkruar për ju. Në raport me pushtetin autoritar çështja nuk është a po të le hapësirë për të shprehur vullnetin, por a po të lejon vullnet të lirë në përgjithësi", ka shkruar Molliqaj në "Faebook".



## Kurti takon Gërvallën dhe Pecin: Procesi zgjedhor është çështje muajsh, duhet harmonizim me opozitën

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryeministri Albin Kurti pati një darkë pune me bashkëdrejtuesit e partisë Guxo, njëherësh zëvendëskryeminstren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, si dhe kryetaren e Alternativës, njëherësh kryetaren e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila.

Gjatë darkës u zhvillua një diskutim përmbajtësor mbi zhvillimet aktuale, arritjet dhe sfidat e përmbushjes së agjendës legislative si dhe planet për të ardhmen, me fokus në agjendën legislative në interes shtetëror dhe përtej vijave ndarëse politike.



Në takim u trajtuan edhe kërkesat dhe qëndrimet e opozitës aktuale në Kuvendin e

Kosovës lidhur me procesin zgjedhor. Aty u theksua se duke qenë se legjislativi dhe qeverisja

kanë arritur në vitin e katërt të mandatit, është e kuptueshme se procesi zgjedhor është çështje e

muajve, por që pajtimi për hapat e mëtutjeshëm duhet të jetë në përputhje me vullnetin e qytetarëve të Republikës si dhe harmonizimin e plotë të kërkesës së partive opozitare karshi pozitës në Kuvend. Vetëm atëherë mund të trajtohen seriozisht nismat për diskutime të procesit të ri zgjedhor.

Në cilindo skenar partnerët e koalicionit qeverisës u shprehën të gatshëm dhe tërësisht të bindur se vlerat e kultivuara të demokracisë dhe progresi i deritanishëm i qeverisë do të vazhdojë bashkë me përcaktimin tonë për shtet demokratik të zhvilluar, me sundim të rendit dhe ligjit dhe për integrim në strukturat veri atlantike. Kurti këto ditë ka takuar edhe kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, por ftesën e tij e kanë refuzuar lideri i LDK-së dhe ai i AAK-së.

## Konjufca dhe Gjeloshaj diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit Kosovë - Mali i Zi

Prishtinë, 15 maj - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim zëvendëskryeministrin për çështje ekonomike, njëherësh ministër për Zhvillim Ekonomik i Malit të Zi, Nik Gjeloshaj.

Duke e falënderuar zëvendëskryeministrin Gjeloshaj për vizitën në Kosovë, kryetari Konjufca vlerësoi lart marrëdhëniet midis Kosovës dhe Malit të Zi si dy shtete me raporte të mira bashkëpunimi.

Konjufca vlerësoi mbështetjen e Malit të Zi ndaj Republikës së Kosovës, duke e konsideruar këtë si tregues të vullnetit dhe gatishmërisë për thellimin e këtyre raporteve.

Kreu i Kuvendit vuri në pah se Republika e Kosovës i



bashkëndan dhe iu qëndron përkrah synimeve zhvillimore

dhe atyre të integritit evropian të Malit të Zi. Sipas tij, ky qëndrim

forcohet edhe më shumë prej faktit të nevojës së përparimit të

rajonit tonë dhe dëshirës për t'i parë gjithnjë e më mirë bashkëkombësit tanë shqiptarë të Malit të Zi.

Teksa biseduan për zhvillimet politike në Kosovë dhe Mal të Zi, kryetari Konjufca tha se me Gjeloshajn u pajtuan se zhvillimi dhe siguria e shteteve tona, si dhe e rajonit, kërkon angazhim të pandërprerë në mbrojtje të sovranitetit, shtetit të së drejtës dhe demokracisë, kërkon qëndrim të palëkundur kundër agjendës dhe influencës ruse në rajon.

Zëvendëskryeministri Gjeloshaj e falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen, duke shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit të mëtejshëm për t'i avancuar interesat e përbashkëta.

## Haziri: Nuk keni parë asgjë akoma, do të shokohen besimtarët politikë të Kurtit

PRISHTINË, 15 MAJ - Nënkyetari i LDK-së, Lutfi Haziri, në "Facebook" ka shkruar se presidentja sot dhe kryeministri dje janë në luftë për betejat të vogla

politike, por s'po shohin se po e humbin luftën. "Këtë javë, në vend se të bëhemi anëtarë të Këshillit të Evropës, në kohën kur Serbia është në bankën e

OKB-së për t'ua vendosur shenjën e gjenocidit përjetë e mot, ata kanë zgjedhur betejat e vogla, duke rikonfirmuar për të satën e herë që interesat personale i

qesin gjithmonë para interesave të shtetit. Po e ripërsëris, nuk keni parë asgjë akoma. Do të shokohen besimtarët politikë të Kurtit!", ka shkruar Haziri.



# Lansohet platforma dhe këndi 'Made in Kosova'

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**BËRNICË, 15 MAJ** - Në ambientet e TechPark Prishtina u përuruar këndi dhe platforma më e re "Made in Kosova", që vjen si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe agjencisë amerikane USAID. "Made in Kosova" apo MIK synon të jetë dritarja e parë digjitale institucionale e cila do ta përmbushë interesimin e njerëzve për të mësuar më shumë për realitetin e potencialin ekonomik, kulturor dhe turistik të vendit tonë.

Në fjalën e tij hyrëse, kryeministri Albin Kurti shprehu se ky projekt paraqet potencialin, kreativitetin dhe veprimtarinë e vendit tonë drejt një njohje të gjerë e një tregu ndërkombëtar përmes misionëve tona diplomatike dhe konsullore. "Platforma 'Made in Kosova' nuk është simbolike, por përmban informata të detajuara mbi dhjetë sektorët kyç të vendit tonë, me shifra të cilat jo vetëm iu shërbejnë investitorëve potencialë, por tregojnë transparencën me të cilën qeveriset vendi ynë", tha ai, duke shtuar se nëse hyn te



sektori i verërave për shembull, aty ke mundësi ta shohësh saktësisht sa hektarë vreshta janë në Rahovec, Suharekë e Malishevë. "Ndërsa te përpunimi i drurit figuron që industria në fjalë kishte 1 miliard euro qarkullim në 5 vitet e fundit. Gjithashtu, platforma krijon mundësi të komunikimit direkt, të kërkesës për vizitë, të cilën MPJD-ja e lidh me departamentin përkatës. Kështu që 'it got lost in the mail' nuk vlen më as për dërguesit e porosisë e as ata të cilët e pranojnë atë", shtëlloi më tej ai. Ai shtoi se platforma krijon

mundësi edhe të komunikimit direkt, të kërkesës për vizitë, të cilën Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e lidh me departamentin përkatës. Ndërkaq këndi fizik i "Made in Kosova" mundëson që prodhuesit, artistët dhe sipërmarrësit tanë të shfaqen në çdo mision diplomatik. Sipas kryeministrit Kurti, synimi i platformës dhe këndit MIK është të ndërtojë një imazh të fuqishëm dhe të besueshëm të Kosovës, duke shtrirë mundësitë për bizneset vendore për të hyrë në tregje të reja dhe për të tërhequr drejtpërdrejt

investime të huaja.

Gjersa po jetësohen këto iniciativa, kryeministri kujtoi mungesën e një platforme të tillë deri më sot, ku si pasojë Kosova qëndroi e izoluar për shumë vjet jashtë vëmendjes që pothuajse të gjitha shtetet evropiane e gëzojnë. "Sot ne shpalojmë vendin ku mund të shihet potenciali dhe puna e vendit tonë. E me emrin e kësaj platforme ne nderojmë miqësinë kosovare dhe të gjithë ata që shërbyen si diplomatë të vendit tonë, para se të kishte ministri të punëve të jashtme e aq më pak ambasadorë", tha ai. **Zëvendëskryeministria** Gërvalla, në fjalën e saj hyrëse, u shpreh se platforma MIK do të ofrojë informata rreth industrive kryesore të Kosovës, të bërit biznes në Kosovë, turizmit, eksportit, ngjarje të ndryshme, si dhe informata të tjera relevante për mërgatën dhe të interesuarit për biznesin, kulturën dhe turizmin në Kosovë. "Ambasadat, konsullatat dhe misionet tona gjithandej botës angazhohen edhe në promovimin e bizneseve tona vendore, në rritjen e eksportit dhe rritjes së biznesit të bizneseve tona me atë të diasporës dhe me bizneset e huaja. Platforma MIK

do të jetë një ndihmesë e madhe edhe në këtë drejtim. Kështu ne rrisim ekonominë tonë, kështu rrisim punësimin, ndalim-migrimin e të rinjve, marrim përvoja të reja dhe fuqizojmë imazhin tonë në botë", tha ajo. Duke qenë fryt i bashkëpunimit me USAID-in, me rastin e lansimit të platformës, si një nga folësit kryesor ishte edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Në fjalën e tij, krahas rëndësisë dhe potencialit në sektorin privat në Kosovë, ai foli edhe për bashkëpunimin rreth krijimit të platformës "Made in Kosova", për të cilën ai tha se do të krijojë hapësirë për diçka shumë të rëndësishme siç është diplomacia komerciale, duke u ofruar investitorëve potencialë të dhëna praktike rreth Kosovës dhe mundësitë për investime. Ndërkaq zëvendësministria Liza Gashi teksa falënderoi të gjithë hisedarët që kanë ndihmuar në këtë platformë dha detaje rreth idesë, zhvillimit dhe punës deri në krijimin dhe lansimin e saj. Ajo foli për zanafillën e projektit të bazuar në analiza dhe të dhëna që kanë treguar për nevojën për një platformë që i përgjigjet interesimit të vizitorëve të shumtë në misionet tona diplomatike.

## Largimi i qytetarëve të kualifikuar, si pasojë e pagës së ulët

**PRISHTINË, 15 MAJ** - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, ashtu si çdoherë, që nga themelimi i saj edhe këtë vit ka organizuar Kuvendin e Rregullt të Punës, ku u diskutua raporti vjetor i punës për vitin 2023, u prezantuan plani i punës për vitin 2024, raporti financiar, planifikimi i buxhetit si dhe u paraqitën problemet aktuale me të cilat komiteti i biznesit është duke u ballafaquar, përfshirë këtu edhe infrastrukturën ligjore.

Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, Skënder Krasniqi, ka falënderuar përfaqësuesit e bizneseve për pjesëmarrjen, anëtarët e bordit për kontributin e tyre në këtë institucion dhe stafin ekzekutiv për punën e palodhshme. Ai ka theksuar se ndershmëria,



integriteti, përgjegjësia financiare, rrjetëzimi, partneriteti dhe komunikimi në mënyrë të qartë e efektive me anëtarët do të vazhdojnë të jenë vlerat kryesore të DHTIK-së. Krasniqi në këtë Kuvend ngriti

edhe sfidën e largimit të qytetarëve të kualifikuar si rezultat i mungesës së sigurimit të familjes me paga të ulëta, sigurimit shëndetësor dhe sigurimit në rast të mbetjes e/i papunë, e që pritet të shkaktojnë dëme pothuajse të

pariparueshme.

Krasniqi ritheksoi kërkesat e domosdoshme të ndryshimeve të ligjeve si: Ligji i punës; Ligji për Tregti të Brendshme; Ulja e TVSh-së në ushqim në 5%; Ulja e TVSh-së në 6% për akomodim në

Hoteleri; Përkrahja me 10% e prodhimeve vendore në blerje në markete; Përkrahje me 10% në eksport për prodhimet që ne i eksportojmë; Përkrahje në rritjen e numrit të të punësuarve dhe krijimi i një oferte reale për investime; Përmirësimi i politikave fiskale si pagesa e TVSh-së në inkasim dhe brenda vendit e jo në Doganë; Krijimi i produkteve strategjike në bujqësi dhe riorientimi i grandeve dhe subvencioneve si rezultat i kësaj; Krijimi i një strategjie reale të zhvillimit ekonomik, e cila i mungon qeverisë në orientimin e investimit të bizneseve etj. Krasniqi ka potencuar se përmirësimi i këtyre ligjeve mundëson që të punohet më shumë dhe në mënyrë më të lehtë.

## Diskutohet për mundësitë e bashkëpunimit ekonomik në mes të Kosovës dhe Armenisë

**PRISHTINË, 15 MAJ** - Gjatë qëndrimit në Armeni, ku po merr pjesë në takimet vjetore të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ministri i Financave, Hekuran Murati, u prit në takim nga ministri i Financave të Armenisë, Vahe Hovhannisyanyan. Përgjatë këtij takimi dy


ministrat diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit ekonomik dhe thellimin e raporteve marrë parasysh ngjashmëritë mes të dyja vendeve. U diskutua edhe për mundësinë e organizimit të vizitave të ndërsjella të delegacioneve biznesore. Gjithashtu, ministri Murati shfrytëzoi rastin ta falënderojë

ministrin Hovhannisyanyan për mbështetjen e ofruar nga Armenia në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. Në përfundim të takimit palët u pajtuan për thellim të bashkëpunimit në procesin e reformave përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira të të dyja vendeve.





# Qesh, bisedo dhe këndo me GPT-4o!



Nga: **Chris STOKEL-WALKER**, autor i librit *How AI Ate the World* / *The Guardian* (titulli original i artikullit: *Laughing, chatting, singing, GPT-4o is AI close to human, but watch out: it's really not human*) / *The Guardian*  
Përkthimi: *Telegrafi.com*

Inteligjenca artificiale [AI], me shpejtësi marramendëse po i ndryshon gjërat. Rreth 18 muaj më parë, kompania e teknologjisë OpenAI e shpaloji çetbotin e saj të AI-së, ChatGPT. Brenda disa muajve, 100 milionë vetë e përdornin rregullisht këtë mjet, duke e bërë aplikacionin me rritjen më të shpejtë në histori. Teksa flluskat e teknologjisë janë gjithmonë të lehta për t'u vërejtur, shumë njerëz pohojnë se bota mund të ndahet në epokën para dhe pas ChatGPT-së.

Ky interesim nuk ishte i papritur. Këtë javë, analistët e trafikut të internetit, Similarweb, njoftuan se faqja e internetit e ChatGPT-së arriti nivele të reja të rekordeve të interesit, me 83.5 milionë vizita në një ditë të vetme në maj. Premisa dhe titulli i librit tim të botuar javën e kaluar, Si e hëngri AI-ja botën [How AI Ate the World], po dalin si të vërteta. AI-ja tani në thelb është e pashmangshme.

Megjithatë, duke bërë turne në vend për të folur për të, unë ende i takoj skeptikët; njerëzit që nuk duan të jenë pjesë e revolucionit të AI-së ose që ende nuk e kanë nevojën për të bashkëvepruar me një çetbot të bazuar në tekst. Njoftimi i së hënës nga OpenAI-ja për një model të ri, GPT-4o, mund ta ndryshojë këtë situatë. Për ata me njohuri teknike, GPT-4o është ndryshim i rëndësishëm. Por, për publikun e gjerë, ndryshimi i rëndësishëm është se sa lehtë është të vepros me të. Përpara GPT-4o-së, mënyra kryesore e ndërveprimit me ChatGPT-in ishte të shkruaje pyetje të bazuara në tekst dhe të prisje përgjigjet e bazuara në tekst. Një ndërfaqe zanore ishte e disponueshme, por e ngathët dhe e ngadaltë. Muajve të fundit jam përpjekur të nxisja ChatGPT-në të më ndihmojë në mësimin e gjermanishtes – për të bashkëbiseduar më mirë me familjen austriake të partneres time – por, vonesat e mërzitshme midis meje duke shtruar pyetje dhe ChatGPT-së duke formuluar përgjigje dhe më pas duke i vokalizuar në mënyrë sintetike fjalët gjermane, shpeshherë në mënyrë të pakuptueshme dhe pa theksin e anglishtes së amerikanëve, e bëri të jetë padobishme.

Demonstrimet e teknologjisë

nga OpenAI-ja në fillim të kësaj jave, këto gjëra i ndryshojnë. Në një pjesë të ngjarjes promovuese, ChatGPT-ja veproi si përkthyes në kohë reale në një bisedë midis anglishtes dhe italishtes. Në një tjetër qeshi si reagim ndaj një “shakaje të fort për babanë”. Dhe, në një tjetër kaloi nga leximi përmendësh i një tregimi për gumë te leximi dramatik i cili edhe aktorin Brian Blessed do ta kompleksonte, përpara se të përfundonte me një këngë.

Sipas OpenAI-së, ky është normaliteti i ri: modeli i AI-së që mund të “rezonojë me audio, pamje dhe tekst në kohë reale”. Në shikim të parë duket të jetë hap tjetër i rëndësishëm drejt shndërrimit të fantashkencës në fakt shkencor. OpenAI-ja sugjeron se gjithnjë e më shumë po afrohet roboti shërbëtor, gjithnjë i dobishëm, gjithnjë në rrymë dhe i ngjashëm me njeriun. Dhe, rrjedha mbresëlënëse e ndërveprimit mund të shmang disa pengesa kundërshtuese drejt të qenit përdorues i AI-së. Gjithashtu ndihmon fakti se do të jetë falas, siç ka bërë më parë OpenAI-ja.

Megjithatë, ia vlen të kujtojmë mëkatën origjinal të AI-së që daton që nga viti 1956: emërtimi i saj. “Inteligjenca artificiale” është sigurisht artificiale, por nuk është ende inteligjente –

dhe, ndoshta nuk do të jetë kurrë. Sa më shumë që ChatGPT-ja dhe mjetet e tjera si ajo do ta imitojnë ndërveprimin njerëzor, duke mësuar që të sillen si rrëfimtari mendjemprehtë dhe të urtë që mund të këndojnë dhe të emocionohen, aq më shumë ka të ngjarë të harrojmë pjesën “artificiale” të këtij termi.

Ndërveprimi i rrjedhshëm të cilin OpenAI-ja është munduar ta mundësojë, e bën një punë të mirë në trajtimin e të çarave bazike të teknologjisë. Kur ChatGPT-ja hyri për herë të parë zhurmshëm në jetën tonë në nëntor 2022, ata që për dekada të tëra e kishin përcjell teknologjinë theksuan se AI-ja në formën e saj aktuale ishte pak më shumë sesa një teknologji e mahnitshme e përputhjes së modeleve – por, u heshtën nga masat e emocionuara. Hapi tjetër drejt ndërveprimit të ngjashëm me njeriun, do të shtojë më shumë zhurmën për të.

Ky është një lajm i mrekullueshëm për OpenAI-në, për një kompani tashmë të vlerësuar në më shumë se 80 miliardë dollarë dhe me investime nga Microsoft-i. CEO i saj, Sam Altman, javën e kaluar postoi se GPT-4o “për të ndihet më shumë si një magji”. Është gjithashtu lajm i mirë për të tjerët në hapësirën e AI-së të cilët po përfitojnë nga prania e

teknologjisë dhe po e vendosin atë në çdo aspekt të jetës sonë. Word-i dhe PowerPoint-i i Microsoft-it tani vijnë me mjete gjeneruese të AI-së në to. Meta, kompania mëmë e Facebook-ut dhe Instagram-it, po e vendos asistentin e saj të çetbotit të AI-së në aplikacionet e saj në shumë vende, gjë që po shqetëson disa përdorues.

Por, kjo është më pak e mirë për përdoruesit e zakonshëm. Më pak fërkime midis kërkimit të një sistemi të AI-së për të bërë diçka dhe përfundimit të detyrës, në fakt është gjë e mirë për lehtësirat në përdorim, por gjithashtu na ndihmon të harrojmë se nuk po ndërveprojmë me qenie të ndjeshme. Duhet ta kujtojmë këtë, sepse AI-ja nuk është i pagabueshëm; vjen me paragjykime dhe çështje mjedisore dhe pasqyron interesat e krijuesve të saj. Këto çështje urgjente janë eksploruar në librin tim dhe ekspertët me të cilët fola më thanë se këto paraqesin shqetësime të rëndësishme për të ardhmen.

Pra, me çdo kusht provojeni ChatGPT-në dhe luani me ndërveprimet e saj me zë dhe me video. Por, kini parasysh kufizimet e saj dhe se kjo gjë nuk është inteligjente, se sigurisht që është artificiale – sado që pretendon se nuk është. //Telegrafi/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Trajneri sulmon Asanin: Është mbipeshë, sa të jem unë nuk luan

Gwangju, 15 maj - Jasir Asani nuk do të luajë asnjë ndeshje deri në nisje të Evropianit. Situata e anësorit është serioze, duke u nisur edhe nga deklaratat që trajneri i tij ka dhënë pak javë më parë. Li Jung Ho e ka aktivizuar vetëm 8 minuta këtë kampionat Asanin, ndërkohë para gazetarëve ai është shprehur

se Jasiri ka shtuar peshë: "Ai ka shtuar shumë peshë dhe s'është mjaftueshëm i mirë në stërvitje. Edhe nëse humbim 10 ndeshje radhazi, Asani përsëri nuk do të luajë me performancën që jep në stërvitje për sa kohë që unë të jem ende trajner". Ylli kuqezi i eliminatorëve të Shqipërisë sezonin e kaluar

shënoi 7 gola dhe 3 asistime në 33 ndeshje të kampionatit, ndërsa këtë vit ka parë vetëm pak minuta në fushë. Trajneri, duke folur për gazetarët, ka vënë në pikëpyetje vendin e tij në Kombëtaren shqiptare. "Ai s'luan sepse performanca aktuale është e dobët. Gabriel ka luajtur mirë. Nuk e di pse është përzgjedhur Asani nga

Kombëtarja shqiptare. Trajneri i Kombëtares shqiptare duhet të mendojë për zgjedhjen e tij", u shpreh pak kohë më parë trajneri i Gwangju FC. Krisja mes Asanit dhe klubit koreano-jugor ka nisur edhe më herët, saktësisht në janar, kur sulmuesi i krahut kërkonte të rikthehej në



futbollin evropian, por pretendimet e ekipit aktual u rritën. 28-vjeçari është në kontratë deri në dhjetor të këtij viti me Gwangju FC.

## Ministri Çeku reagon ashpër ndaj bashkëpunimit Shqipëri - Serbi: Ishim gati, por s'na pyetën fare

PRISHTINË, 15 MAJ - Javën e kaluar Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) zyrtarisht shpali kandidaturën për organizimin e Kampionatit Evropian të Futbollit Euro 2027 për grupmoshat U21. Por, ky kandidim u bë duke bashkuar forcat me Serbinë, lajm ky që ngjalli reagime të ashpra në Kosovë. Një reagim po kaq të ashpër e ka bërë edhe ministri i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrulla Çeku. Duke folur ekskluzivisht për "KosovaPress" rreth kësaj teme, Çeku ka zbuluar se nuk ka pasur fare komunikim të Shqipërisë me Kosovën për këtë aplikim, derisa ka përmendur faktin se Shqipëria është parë partnere e padiskutueshme kur Kosova fitoi të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare. "Sa herë Kosova tenton të organizojë një ngjarje ndërkombëtare, adresa jonë e parë është Shqipëria, këtë e kemi treguar edhe në Lojërat Mesdhetare dhe jo vetëm dje. Të jemi shumë të hapur tani, për Lojërat Mesdhetare ne kishim nevojë për një shtet partner që

kishte dalje në det dhe teknikisht kishte edhe opsione të tjera, por ne asnjëherë nuk kemi menduar për to. Për ne Shqipëria ka qenë partner i natyrshëm, prandaj kemi shkuar vetë dhe kemi insistuar që Shqipëria të jetë partneri i Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Të paktën i njëjti komunikim nuk ka ndodhur në rastin e aplikimit për U21 në futbollit e vitit 2027 nga ana e Shqipërisë", ka theksuar Çeku. Më tutje, i pari i MKRS-së bëri me dije se nuk kanë pasur asnjë informatë për këtë aplikim të Shqipërisë derisa ka hedhur poshtë pretendimet se Kosova është anashkaluar për shkak se nuk e ka infrastrukturën e nevojshme. "Ne vetëm kuptuam lajmin kur u bë publike kandidatura formale dhe kishte një lloj konstatimi për mua pak të çuditshëm nga ana e Shqipërisë, një lloj konstatimi pa konsultim paraprak se ne nuk i plotësojmë kushtet. Nëse flasim për vitin 2027 ne deri atëherë do t'i kemi disa stadione të kategorive të larta që



janë të gatshme për lojë dhe këtë po e them dhe këtë po e them me dinamikën e lojërave që po zhvillohen tani, është analizë e bazuar e nuk është premtim elektoral. Dinamika e punëve në teren si po zhvillohen dhe afatet e përmbylljes na tregojnë që brenda dy viteve ne do t'i kemi disa stadione të kategorive të larta që janë të gatshme dhe besoj që me këtë ne do ta kishim plotësuar

edhe kushtin e nevojshëm minimal për të qenë bashkë-organizatore e këtyre lojërave", ka shtuar i pari i MKRS-së. Më tutje, Çeku theksoi se zhgënjimi ishte edhe më i madh ku u bë e ditur se Serbia nuk është e gatshme me infrastrukturën që kërkohet dhe se për këtë organizim dhe se atje sapo kanë nisur investimet në disa stadione, andaj duke parë këtë situatë, sipas

Çekut, Shqipëria është dashur të jetë më korrekte në këtë rast ndaj Kosovës. "Reagime kishte shumë. Natyrisht unë shpresoj që ato nuk prishin raportin shumë të mirë mes Kosovës dhe Shqipërisë në shumë fusha, përfshirë edhe në sport, mirëpo pak më shumë korrektesë do të ishte më mirë në këtë rast. Të paktën komunikimi të kishte ekzistuar me kohë, ne të ishim të informuar, ne ta kishim versionin tonë të transmetuar qartë në anën tjetër. Ajo çfarë ndodhi pas atij lajmi, ishin informatat se edhe Serbia nuk është ende e gatshme me infrastrukturë të futbollit për këtë organizim të vitit 2027 dhe ata tek tani janë duke investuar në disa stadione për t'u bërë gati. Prandaj arsyetimi se Kosova nuk është e gatshme nuk qëndron sepse po del që as Serbia nuk qenka e gatshme për atë lloj organizimi", ka deklaruar Çeku. Kandidatura e Shqipërisë bashkë me Serbinë është në shqyrtim e sipër dhe se vendimi pritet të merret nga UEFA në javët e ardhshme.

## Sonte përballja e tretë finale në mes të Trepçës dhe Yllit



Mitrovicë, 15 maj - Trepça dhe Golden Eagle Ylli do të përballen në finalen e tretë të "play-off"-it të enjten mbrëma. Seria finale është 1:1, derisa skuadra që shënon tri fitore do të shpallet kampione e Kosovës. Dy sfidat e para kanë qenë të jashtëzakonshme, duke paralajmëruar duela të 'zjarrta'

në finale, që është ajka e fundit të kampionatit. Ndeshjen e parë e fituan mitrovicasit 77:68, kurse atë të dytë therandasi 80:79. "Xehetarët" kërkajnë trofeun e katërt për këtë edicion, pas Kupës, Superkupës dhe Ligës Unike dhe titullin e pestë në histori, derisa therandasiit titullin e tretë në histori, pasi më

2021 dhe 2022 u shpallën kampione të Kosovës. Në këtë edicion janë përballur shtatë herë deri më tani. Në garat e rregullta u ndanë 2:2, derisa 'Xehetarët' triumfuan në finale të Ligës Unike, kurse seria finale është 1:1. Takimi zhvillohet të enjten mbrëma (19:00) në "Minatori".

## Qerimi, Shabani dhe Shala në edukimin për licencën 'Master'

Prishtinë, 15 maj - Dy selektorët e Kosovës në hendboll, Bujar Qerimi e Agron Shabani, si dhe kryetari i Shoqatës së Trajnerëve të Hendbollit të Kosovës, Faruk Shala, janë pjesë e edukimit për licencën

"Master" që është më e larta për trajnerë të hendbollit. Shkollimin për "Master" po e organizon EHF-ja në bashkëpunim me Federatën e Hendbollit të Kroacisë. Shkollimi bëhet në kuadër të RINCK

Konventës, ndërsa moduli i parë për Master po mbahet në Poreç të Kroacisë, prej 13 deri më 19 maj. Këtë shkollim federata kroate në bashkëpunim me EHF-në e organizon për herë të tretë. Po e

ndjekin trajnerë me nam nga Kroacia, Sllovenia, Gjermania, Bosnjë-Hercegovina, Belgjika e Kosova. Në mesin e tyre ka edhe emra shumë të njohur të hendbollit botëror.



## Lewandowski pritet ta marrë 'Topin e Artë 2020'

Paris, 15 maj - Pas katër vitesh drejtësia mund të vendoset për Robert Lewandowskin, me sulmuesin polak që mund ta marrë "Topin e Artë" që iu "mohua" në 2020-n për shkak të pandemisë "Covid-19". Nga Spanja raportohet se "France

Football" mund të bëjë një hap prapa, duke planifikuar prej dy muajsh tashmë që t'i japë polakut trofeun që i përket. Në atë sezon, Lewandowski kishte fituar tripletë me Bayern Munich, duke marrë në shtëpi trofeun e

Bundesligas, Kupës së Gjermanisë dhe më kryesorin Ligën e Kampionëve. Ndërsa në nivel personal, në atë sezon polaku shënoi 55 gola në 47 ndeshje të luajtura, për atë që ishte viti më i mirë i jetës së tij futbollistike. Statistika që e

bën atë të ishte lojtari më i mirë në botë në atë kohë, por "Topi i Artë" nuk iu dha kurrë. Tani, pas katër vitesh, drejtësia mund të vendoset dhe për Lewan do të ishte qershia mbi tortë e një karriere vërtet të jashtëzakonshme.



## FIFA mund ta përjashtojë Izraelin për shkak të Palestinës

BANGKOK, 15 MAJ - Në Bangkok, të premten, më 17 maj, 211 delegatët në asamblenë e Federatës Ndërkombëtare të Futbollit (FIFA) do të vendosin mbi kërkesën e Palestinës për sanksione kundër Federatës së Futbollit të Izraelit për shkak të konfliktit izraelito-palestinez në Gaza. Në prill Federata e Futbollit të Palestinës (PFA) i bëri thirrje FIFA-s ta ndalojë Izraelin nga garat ndërkombëtare. PFA ka paralajmëruar për diskriminim dhe racizëm në ligat izraelite dhe se Federata e Futbollit të Izraelit (IFA) po thyen statutet e saj duke përfshirë ekipet e futbollit me bazë në territorin palestinez në ligën e saj. Duke vepruar kështu, ata tërhoqën vëmendjen te neni i katërt i statutit të FIFA-s, i cili ndalon shprehimisht çdo diskriminim ndaj një vendi ose grupi tjetër njerëzish dhe thotë se çdo shkelje e tillë dënohet me "pezullim ose përjashtim". Kësaj i shtohen edhe fansat. Ata veçuan klubin e Jerusalem Beitarit, ku ofendimi i futbollistëve arabë është pjesë e përditshmërisë së tifozëve. PFA vazhdon të parandalojë sistematikisht tifozët arabë që të bashkohen me klubet,



anëtarët e menaxhmentit të klubit shpesh shprehin qëndrimin e tyre racist ndaj arabëve në rrjetet sociale dhe anëtari i Maccabi Netanya u akuzua për mbështetjen publike të gjenocidit në Gaza në LinkedIn. Në të njëjtën kohë, sipas PFA, shumë futbollistë izraelitë janë gjithashtu anëtarë të ushtrisë që aktualisht po kryen mizori në Gaza. PFA paralajmëron se Izraeli ka shkatërruar plotësisht infrastrukturën e futbollit në Gaza, me disa stadione të kthyer në kampe, spitale dhe madje edhe varreza masive. Edhe para konfliktit të fundit,

problemet me dhënien e lejeve të ndërtimit për objektet sportive në Palestinë ishin të vazhdueshme. Propozimi i PFA-s tashmë është mbështetur zyrtarisht nga federatat e futbollit të Algjerisë, Irakut, Jordanisë, Sirisë dhe Jemenit. FIFA nuk iu përgjigj publikisht kërkesave. Nga pala izraelite kërkesa u vlerësua si cinike dhe e paturpshme. "Ne nuk e marrim lehtë kërkesën dhe jemi të gatshëm të luftojmë për të arritur një fitore morale dhe reale kundër gjithë këtyre hipokritëve dhe armiqve", ka deklaruar pala izraelite.

## Denveri përmbysi Minnesotan, New Yorku rimerr avantazhin

DENVER, 15 MAJ - New York Knicksi rikthehet në epërsi në gjysmëfinalet "play-off" ndaj Indianas, pas fitores me rezultat 121-91 ndaj Indianas, duke udhëhequr 3-2 me ndeshje. Një sfidë pa histori, dominuar nga nju-jorkezët, që në fushën e tyre nuk tolerojnë. Jalen Brunson me 44 pikë bëri diferencën në parket,



duke qenë më i miri në fushë. Për Indianan, lojtari më i mirë ishte Siakam me 22 pikë, por që mbetën për statistikë. Në Konferencën e Perëndimit, skuadra e Denverit përmbysi disavantazhin 0-2 pas dy ndeshjeve të para dhe tashmë udhëheq 3-2. Kampionët fituan me rezultat 112-97 ndaj Minnesotas në fushën e tyre. Ndeshje e shkëlqyer për Nikola Jokiqin, që realizoi 40 pikë e 13 asistime, i karikuar pas fitimit të çmimit MVP. Për Minnesotan u dallua Townsi me 23 pikë, por që s'mjaftuan për të fituar.

**KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"**  
New York - Indiana 121-91 (3-2)  
Boston - Cleveland (3-1)

**KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"**  
Denver - Minnesota 112-97 (3-2)  
Oklahoma - Dallas (2-2)

### SHKURT

#### Shiten orët e Schumacherit për një shumë të çmendur

Orët që i përkasin të madhit të Formulës 1, Michael Schumacher, u shitën për rreth pesë milionë euro në ankandin e Christie's në Gjenevë të martën. Tetë orët, duke përfshirë orët Rolex, FP Journe dhe Audemars Piguet, u nxorën në shitje nga familja e Schumacherit, i cili nuk është parë në publik që kur pësoi një lëndim të rëndë në kokë në një rënie gjatë skijimit jashtë pistës në 2013. Një orë FP Journe me një mesazh të gdhendur dhënë Schumacherit si dhuratë për Krishtlindje nga shefi i ekipit të tij Ferrari, Jean Todt, u shit për 1.8 milion euro. Një orë tjetër me porosi, një Royal Oak nga Audemars Piguet, u shit për 500 000 euro, duke tejkaluar vlerësimin e saj prej 180 000 deri në 300 000 euro. "Koleksionistët ishin shumë të lumtur që zbuluan këto ora të zhytura në histori", deklaroi Remi Guillemin, kreu i orëve të Christie's në Evropë. Orët e lidhura me 55-vjeçarin shtatë herë kampionin e botës Schumacher janë pjesë e një koleksioni më të gjerë në pronësi të familjes.

#### Guardiola nuk feston: Asgjë nuk ka përfunduar

Manchester City pas fitores ndaj Tottenham Hotspurit (0-2) i është afruar edhe me shumë titullit në Premier Ligë. Pavarësisht se mediet e konsiderojnë tani të mbyllur garën për titull, nuk e sheh në këtë mënyrë edhe trajneri Pep Guardiola. "Jam i lumtur për atmosferën në dhomat e zhveshjes, por nuk pashë një festë ekstra. Lojtarët e dinë se asgjë nuk ka përfunduar. Njerëzit duhet të vijnë në 'Etihad' të dielën që në orën 15:00, të përcjellin energji, të na shtojnë të fitojmë në çdo centimetra pasi do të jetë e vështirë. Unë e di që do të jetë një ndeshje e ngjashme me atë kundër Aston Villas, për shkallën e vështirësisë dhe emocioneve, por unë i njoh lojtarët e mi, e di që ata mund ta përballojnë presionin", ka thënë Guardiola.

#### Ancelotti: Dua që Kroosi ta fitonte 'Topin e Artë'

Real Madridi po i shijon ndeshjet e fundit në La Liga, kompeticion të cilin e fitoi për herë të 36, si asnjë skuadër tjetër në Spanjë. Djemtë e Carlo Ancelottit triumfuan 5-0 kundër Alavesit, ndërkohë që gjithë fokusi është te finalja e Champions League kundër Borussia Dortmundit. E programuar për datën 1 qershor në "Wembley", "Los Blancos" dëshiron ta fitojë turneun më të rëndësishëm për klube, aty ku është rekordmen krahasuar me rivalët - për herë të 15-të në histori. Pas suksesit me "manita" në "Santiago Bernabeu", Ancelotti u ndal gjatë fjalës së tij te Toni Kroos. Prej vitesh një ndër mesfushorët më të mirë në planet, bashkë me kolegun Luka Modriq. "Do të doja shumë ta shihja Kroosin duke fituar 'Topin e Artë', por nuk mendoj se do të ndodhë... Gjithsesi, asgjë nuk është e pamundur. Kemi Evropianin këtë verë. Nëse Toni fiton Ligën e Kampionëve dhe 'Euro 2024' me Gjermaninë atëherë mund të luftojë për fitimin e Topit të Artë", theksoi tekniku italian. 34-vjeçari nga Greifswald po kalon një formë të mrekullueshme dhe është afër fitimit të Ligës së Kampionëve për herë të gjashtë me fanellën e Realit. Kroos u rikthye edhe në kombëtaren gjermane gjatë këtij viti.

## Vasseur: Ishte lehtë ta bindja Hamiltonin të vinte te Ferrari

Te Ferrari ka nisur një mini-revolucion këtë vit, me objektiv që makina të jetë sa më konkurruese vitin tjetër e veçanërisht në vitin 2026, kur hyjnë në fuqi rregullat e reja. Lewis Hamiltoni është piloti që do të afrohet nga 1 janari 2025, ndërkohë që pritet edhe Adrian

Newey. Ardha e Lewis Hamiltonit në Maranello tronditi jo pak botën e Formula 1 dhe ka elektrizuar tifozët e kuq. Një rol vendimtar në këtë çështje luajti Frederic Vasseur, drejtor i "kokëkuqes", që foli për prapaskenat e bisedimeve me 7 herë kampionin e botës. "E di

profesionalizmin e tij. Jo se pilotët tanë nuk e kanë, por Lewisi ka një vizion të ndryshëm për gjërat dhe ne mund të përfitojmë prej tij. Ai ka përvojë të madhe edhe në fitimin e kampionateve. Ai do të kontribuojë me njohuritë e tij. Është dikush që di të bëjë presion

mbi ekipin me qëllimin për të arritur përsosmëri", ka thënë Vasseur. Transferimi i Hamiltonit krijoi habi, por jo për francezin: "Sinjerisht, nuk ishte aspak e vështirë. Mendoj se ai e kishte në mendje prej shekujsh të

bashkohej me Ferrarin. Këtë vit u realizua për disa arsye, duke përfshirë faktin që ai kishte mundësinë të largohej nga Mercedes. Ishte koha e duhur për secilin prej nesh. Mendoj se është një mundësi e mirë për të dhe për ne".

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 1" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Dobroshec, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2024 në ora 09:00 në objektin e komunës se Drenasit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495  
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 1" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Dobroshec, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 4" me kapacitet 7.47 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2024 në ora 10:30 në objektin e komunës se Drenasit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495  
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 4" me kapacitet 7.47 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 5" me kapacitet 7.29 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Çikëtove e Re, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2024 në ora 11:00 në objektin e komunës se Drenasit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495  
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 5" me kapacitet 7.29 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Çikëtove e Re, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 6" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2024 në ora 11:30 në objektin e komunës se Drenasit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495  
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Glllogoc për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 6" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Gllgoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 2" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Dobroshec, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2024 në ora 09:30 në objektin e komunës së Drenasit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Gllgoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495  
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Gllgoc për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 2" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Dobroshec, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Gllgoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 3" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Dobroshec, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2024 në ora 10:00 në objektin e komunës së Drenasit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Gllgoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495  
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Yildirim Energy Europe Kosovo" Sh.p.k Gllgoc për parkun solar fotovoltaik, "Feronikeli 3" me kapacitet 9.96 MWp në ZK Çikëtove e Vjetër dhe Dobroshec, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

#### NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 19.04.2024, për vendin e punës:

**I. Pozita:** Përkthyes – nga gjuha shqipe në gjuhë serbe anasjelltas

**Numri i referencës:** RPSA/ZKA/04-06/24

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr.576 të datës 15.05.2024.

Prishtinë, 15.05.2024

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

#### OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 19.04.2024. godine, za radno mesto:

**I. Položaj:** Prevodilac - sa albanskog na srpski i obrnuto;

**Broj reference:** RPSA/ZKA/04-06/24

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 576 od datuma 15.05.2024.

Priština, 15.05.2024

Departman za upravljanje ljudskim resursima

#### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Hevzi .A. Xhelili shpallë të pavlevshme Dipomen e shkollës së Lartë Komerciale "Haxhi Zeka" Pejë.

Arlind Pnishi nga Gjakova shpall të pavlevshme dëftesat e sh.m.l.m. "Hysni Zajmi" të kl. 10.11.12 në Gjakovë.

Dion Millanga Gjakova shpall të pavlevshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Teknike "N. Nixha" Informatik në Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Austrian Institute Of Excellence” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810971954 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Austrian Institute Of Excellence” D.O.O. Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810971954 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Austrian Institute Of Excellence” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810971954 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## Thirrja për aplikim

(DHËNJE TË OFERTËS)

“NERXHIVANE HAZIRI” B.I. me Numer Unik.Biz: 810790354 me seli Magjistranja Podujeve p. n. Komuna Podujevë me pronare NERXHIVANE HAZIRI, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim: për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

1. Makine per mbjelljen e perimeve, patateve, demsan 2 rendore PD2 super automatike,
2. Makine profesionale per nxjerren e karrotave, patateve unia me shirit transportues dhe per selektim,
3. Rimorkio (per shperndarje te plehut organik) 5 ton
4. Pllug Rrotullues 3 rendor Alpler,
5. Pirunier Elektrik (minimum 1.5 ton)
6. Kosha per Karrota - 100 cope (druri)
7. Energji Solare 3.5 kw.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek “NERXHIVANE HAZIRI” B.I. NERXHIVANE HAZIRI (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorëzimit të Ofertave 10 ditë nga data e pranimit te ftesave per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: Magjistranja Podujeve p.n. Komuna Podujevë  
Për Informata Shtesë tel: +383 44 170 417 dhe në email adresën:

fuadhaziri@gmail.com



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**

